



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:026766
Datë: 01.08.2023
Numri i dokumentit: 04543765

C-IV-14-1870

Ankuesi

N B Mitrovicë.

Kundër

E paditura

NSH “LUX”, në Likuidim, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**,

Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakërishtë-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 01 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET Vendimi i Autoritetit të Likuidimit MIT039-0403, të datës 24 shkurt 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 mars 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. MIT039-0403, i datës 24 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për tri paga të papaguara në shumën prej 180.00 €, nga N.SH “LUX” (në likuidim). Ankuesi e kundërshton vendimin e AL-së për arsye të shkeljes së prezumimeve procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së materiale. Ankuesi ka pohuar se ka qenë punëtor aktiv në ndërmarrjen e sipërpërmendur deri në momentin e privatizimit të Shtëpisë së mallrave, pronës së parë të privatizuar nga AKP-ja, konkretisht në muajin mars të vitit 2004, duke

pretenduar se ka qenë në listën e pagave në tri vitet e fundit para privatizimit. Po ashtu ka pohuar se ai ishte përfituese e 20%. Ankuesi i propozon gjykatës që të aprovohet kërkesa e tij, si dhe ti njihet kompensimi në shume prej 180.00 euro, si dhe ti njihen shpenzimet procedurale. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar, Vendimin e kundërshtuar nr. MIT039-0403, të datës 24 shkurt 2014.

Me 14 nëntor 2016, e paditura AKP ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka bërë zbatim të saktë të dispozitave ligjore. E paditura ka pohuar se ankuesi kërkesën e ka dorëzuar jashtë afatit për parashtrimin e kërkesave në procedurën e Likuidimit. AKP tutje i referohet dispozitave ligjore konkretisht nenit 35.3 i lexuar bashke me nenin 7.2.6.3 dhe 7.2.6.4 të shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, i cili parashikon që “kërkesat dhe interesat qe nuk janë parashtruar si duhet deri në afatin për parashtrimin e kërkesave do të refuzohen dhe do të jenë gjithmonë të parashkruara dhe të pa ekzekutueshme”. AKP tuje pohon se ka kryer të gjitha publikimet e kërkuara me ligj lidhur me likuidim. Po ashtu AKP e kundërshton ekzistencën edhe lartësinë e detyrimit te pretenduar dhe thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas së cilit pala kërkuese ka detyrimin dhe barrën e provës, neni 7 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe neni 23 i shtojcës së Ligjit 04/L-033. AKP ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar. Përgjigjes në mbrojtje e paditura i ka bashkangjitur , kopjet e publikimeve të afatit për parashtrimin e kërkesave kreditore në gazetat Koha Ditore dhe Kosova Sot.

Me 23 nëntor 2016, mbrojtja e të paditurës i është dorëzuar ankuesit, i njëjti nuk parashtroi përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (shkurt AKM) për parashtrimin e kërkesave kreditore. N.SH “LUX” kishte hyr në proces të likuidimit me 19 Gusht 2013. AKM me 28 gusht 2013 dhe 05 shtator 2013 kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të N.SH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të N.SH “LUX” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me datën 11 Tetor 2013. Publikimet ishin bërë në shtypin ditor “Koha Ditore” dhe “Kosova Sot”, prandaj në këtë mënyrë janë plotësuar edhe standardet ligjore për njoftimin e kreditorëve. Nga shkresat e lëndës del se ankuesi kërkesën e tij Autoritetit

të Likuidimit ia kishte parashtruar me datë 14 tetor 2013, që i bie se ankuesi e ka parashtruar kërkesën 3 ditë me vonesë të pajustificuar në paraqitjen e kërkesës së tij para AL .

Gjykata gjithashtu vëren se AL me rastin e shqyrtimit të kërkesë së ankuesit drejtë kishte aplikuar dispozitat ligjore, përkatësisht nenin 35 paragrafi 3 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në Nr. 04/L-034. Ankuesi nuk kishte dorëzuar ndonjë justifikim bindës lidhur me vonesën për dorëzimin e kërkesës së tij. Pretendimi i ankuesit se ai nuk ishte informuar që NSH-ja kishte hyre në procedure të likuidimit pasi që ai jeton në Mitrovicën Veriore nuk është arsytim i justifikueshëm, pasi që AL-ja kishte publikuar në mënyrë të rregullt njoftimet e likuidimit në internet nga dy herë. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në Dhomën e Posaçme kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (C-IV-13-0003, C-IV-13-0652, C-IV-13-1754, C-IV-13-2063 dhe AC-I-14-0090) për refuzimin e ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditore janë parashtruar jashtë afatit për paraqitjen e tyre në AL.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi është e liruar nga pagimi i taksës gjyqësore meqë vlera e kontestit është nën 1000 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar